



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 21 shkurt 2012

Z. Bajram Rexhepi
Ministër i Punëve të Brendshme
Republika e Kosovës

RAPORT

Ex-officio nr. 28/2012

Lidhur me ngjarjet në protestat e datës 14 dhe 22 janar 2012

I nderuari z. Rexhepi,

1. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 15.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka vendosur të hapë hetime sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) në lidhje me ngjarjet në protestën e organizuar nga Lëvizja Vetëvendosje.
2. Bazuar në deklaratat në lidhje me mbajtjen e protestës së paralajmëruar dhe tensionimin e gjendjes,¹ Avokati i Popullit, me qëllim të mbikëqyrjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ka vendosur të monitorojë zhvillimin e ngjarjeve më 14 janar 2012, te pikat kufitare Dheu i Bardhë dhe Merdare. Për këtë arsye janë angazhuar 4 ekipe, me nga dy vëzhgues nga IAP.

Zhvillimi i ngjarjeve para protestës së datës 14 janar 2012

3. Më 7 dhjetor 2011, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi mocionin lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë të propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje.²
4. Më 18 dhjetor 2011, Lëvizja Vetëvendosje kërkoi nga Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë së zbatuari mocionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke filluar nga 1 janari i vitit 2012.

¹ Deklaratë e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, Molliqaj për media: “*Ne do të qëndrojmë aty derisa Qeveria të mos fillojë ta zbatojë vendimin e Kuvendit të Kosovës*”; Deklaratë për media e Ministrit të Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, Bajram Rexhepi: “*Të gjithë ata që e përkrahin Lëvizjen Vetëvendosje të shtunën mund të përballen me përdorim të forcës nga ana e Policisë së Kosovës.*”
Në: <http://www.gazetaexpress.com/index.php/artikujt/rubrika/C21/C6/?cid=1,15,71429> (10.02.2012); dhe <http://www.gazetaexpress.com/index.php/artikujt/rubrika/C21/C6/?cid=1,15,71429> (10.02.2012).

² Transkripti i seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtur më 7 dhe 8 dhjetor 2011: “me 42 vota “*për*”, 33 vota “*kundër*” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi mocionin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!” Në http://assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2011_12_07_10_3884_al.pdf (24.01.2012).

5. Më 5 janar 2012, përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje, në një konferencë të organizuar për mediat, deklaruan se *“Lëvizja Vetëvendosje, më 14 janar do t'i bllokojë dy pikat kufitare me Serbinë në Merdare dhe te Dheu i Bardhë”*, që të pengojnë hyrjen e mallrave të Serbisë.³
6. Në kuadër të praktikave të planifikimit paraprak të zhvillimit të protestës së paralajmëruar, më 12 janar 2012, përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje u takuan me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës për të sqaruar detajet e aktivitetit të datës 14 janar 2012.
7. Më 14 janar 2012, përfaqësuesit e IAP-së, të organizuar në 4 ekipe vëzhguese me nga 2 bashkëpunëtorë të IAP-së, monitoruan zhvillimet e protestës në të dy pikat kufitare, në Merdare dhe te Dheu i Bardhë. Përfaqësuesit e IAP-së vëzhguan pandërprerë në vendin e ngjarjes, në Besianë (Podujevë), përkatësisht te Dheu i Bardhë, që nga ora 10.00 deri në orën 21:00, të datës 14 janar 2012.
8. Më 15 janar 2012, në konferencën e organizuar për media, në selinë e vet në Prishtinë, Lëvizja Vetëvendosje, paralajmëroi se *“Protesta e ardhshme paqësore në bllokim të mallrave dhe automjeteve të Serbisë, do të mbahet sot një javë, pra të dielën tjetër, më 22 janar 2012.”*⁴
9. Për shkak të tensionimit të mëtejshëm të gjendjes pas ngjarjeve të 14 janarit 2012, dhe akuzave të ndërsjella për përdorim të forcës, tensionimi i marrëdhënieve kishte pasojë. Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje nuk u takuan fare me Policinë e Kosovës për të sqaruar detajet e aktivitetit të datës 22 janar 2012, ashtu siç kishte ndodhur më 12 janar 2012.⁵ Me gjithë acarimin e marrëdhënieve midis organizatorëve të protestës dhe qeverisë së Kosovës, një veprim i këtuillë, mungesa e çfarëdo kontakti për të sqaruar detajet teknike të zhvillimit të protestës, është i palejueshëm, i rrezikshëm dhe shpie tek një acarim dhe tensionim i mëtejshëm i situatës në përgjithësi dhe shqetësim tek qytetarët.
10. As më 14 janar dhe as më 22 janar, organizatorët e protestës nuk kanë kërkuar leje nga Policia e Kosovës për mbajtjen e protestës. Edhe pse kjo nuk është kërkesë ligjore në një shoqëri të hapur dhe demokratike,⁶ një lajmërim i tubimit, për t'i mundësuar autoriteteve për të bërë aranzhimet e duhura për mbarëvajtjen e tubimit, është një veprim i domosdoshëm praktik i karakterit funksional, sidomos në rastet e ngjashme, kur pritet numër i madh i pjesëmarrësve në vende dhe hapësira që nuk janë të parapara për grumbullimin e një numri të madh të personave.⁷

³ VETËVENDOSJE! Gazetë javore | 9 janar 2012 | nr . 324,

në: http://www.vetevendosje.org/repository/docs/vetevendosje_324.pdf (25.01.2012).

⁴ Konferencë për media, Lëvizja Vetëvendosje, në: <http://www.vetevendosje.org/?cid=1,2,3845> (26.01.2012)

⁵ European Commission for Democracy Through Law (venice commission), sce/odihr – Venice Commission Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly, (2nd edition), Prepared by the OSCE/ODIHR Panel on Freedom of Assembly and by the Venice Commission, Adopted by the Venice Commission at its 83rd Plenary Session, (Venice, 4 June 2010). CDL-AD(2010)020 Or. Engl., Study no. 581/2010. Strasbourg- Warsaw, 9 July 2010, par. 187. (Në vijim si: Venice Commission, Study no. 581/2010. Strasbourg- Warsaw, 9 July 2010). “Planifikimi paraprak me zyrtarët e zbatimit të ligjit lidhur me ngjarjen: Kur është e mundur, është praktikë e mirë për organizatorin/organizatorët të arrihet pajtimi me zyrtarët e zbatimit të ligjit lidhur me faktin se çfarë masash të sigurisë publike po ndërmerren para ngjarjes[...].”

Në : <http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD%282010%29020-e.asp> (26.01.2012).

⁶ Ligji për tubimet publike, Nr.03/L-118, neni 5, pika 4. “Çdo tubim publik duhet detyrimisht të lajmërohet nga organizatori apo përfaqësuesi i tij nën kushtet dhe afatin e paraparë nga organet e policisë.” dhe neni 6, pika 1. “Lajmërimi për organizimin e tubimit të qetë publik për qëllimin, vendin dhe kohën e organizimit bëhet para policisë së Kosovës në vendin ku mbahet tubimi.”

⁷ Venice Commission, Study no. 581/2010. Strasbourg- Warsaw, 9 July 2010), par. 113: “Nuk është e domosdoshme, sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për legjislacionin vendor që të kërkojë njoftim paraprak lidhur me një tubim. Në të vërtetë, në një shoqëri të hapur, shumë lloje të tubimeve nuk kërkojnë ndonjë formë të rregullimit zyrtar. Prandaj, njoftimi paraprak do të duhej të kërkohej vetëm kur qëllimi është që shtetit t'i mundësohet të bëjë aranzhimet e domosdoshme për të lehtësuar lirinë e tubimit dhe për të mbrojtur rendin, sigurinë publike dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve.”

Zhvillimi i situatës në Podujevë, më 14 janar 2012

11. Përfaqësuesit e IAP-së (2 ekipe me nga dy vëzhgues), në orën 9:25, përgjatë rrugës Prishtinë - Podujevë, kanë vërejtur praninë e shtuar të policisë. Patrullat e policisë ishin vendosur në fshatrat Prugovc, Vranidoll, Lupç të Poshtëm dhe Lluzhan. Ndërsa një numër i madh i pjesëtarëve të Njesisë Speciale të Policisë ishte vendosur në hyrje të qytetit të Podujevës, në afërsi të ish-hotelit “Besiana”, në magjistralen që shpie në drejtim të pikës kufitare në Merdare.
12. Përfaqësuesit e IAP-së, në orën 11:00, kanë vizituar pikën kufitare në Merdare. Aty ishte vendosur numri më i madh i pjesëtarëve të Njesisë Speciale të Policisë, të pajisur me helmata dhe mjete të tjera mbrojtëse, vërehej prania edhe automjeteve ujëhedhëse për shpërndarjen e protestuesve me ujë, si dhe automjete të tjera të Policisë së Kosovës. Në Merdare, përfaqësuesit e IAP-së, u takuan me z. Vladimir Qirkoviq, komandant i pikës kufitare në Merdare, i cili i njoftoi se deri në atë moment nuk kishte pasur ndonjë incident dhe se automjetet lëviznin lirshëm dhe pa pengesa në të dyja anët e kufirit, por se numri i automjeteve ishte jashtëzakonisht i vogël. Ai po ashtu njoftoi se komanda e policisë ishte zhvendosur në stacionin e policisë në Podujevë dhe se për të gjitha zhvillimet gjatë ditës kompetent për dhënien e informacioneve ishte komanda në Podujevë.
13. Nga ora 12:25 deri në orën 13:00, në segmentin rrugor Podujevë-Prishtinë, ekipi lëvizës i IAP-së ka vërejtur se policia kontrollonte autobusët, veturat dhe automjetet e tjera, në fshatrat Lluzhan dhe Prugovc, si dhe tek udhëkryqi që shpie në drejtim të Mitrovicës. Po ashtu, edhe në pikën kufitare në Merdare, deri në orën 13:00 situata ishte e qetë, mirëpo në këtë interval kohor disa dhjetëra pjesëtarë të Njesisë Speciale të Policisë nisen në këmbë nga pika kufitare në Merdare në drejtim të Podujevës, duke kthyer mbrapa personat të cilët kishin shfrytëzuar rrugët anësore dhe ishin nisur në drejtim të pikës kufitare. Pjesëtarët e Njesisë Speciale të Policisë ishin në përcjellje të disa automjeteve të blinduara, të cilat në orën 14:00 i afrohen udhëkryqit, ku ishte vendosur kordoni policor, i cili kishte bllokuar rrugën dhe ku ishin grumbulluar disa qindra protestues.
14. Në anën tjetër të kordonit të policisë, rreth orës 14:00, një automjet (kombibus), i cili kishte depërtuar nga mesi i protestuesve iu ofrua kordonit të policisë. Ai nuk u lejua të vazhdonte rrugën nga policia, sepse mbante shenja të protestuesve.
15. Numri i protestuesve sillej rreth 600-700 persona. Gjatë gjithë kohës njëri nga protestuesit, përmes megafonit, i bënte thirrje policisë të lirojë rrugën dhe bënte thirrje kundër produkteve të Serbisë.
16. Në orën 14:05, përmes megafonit, policia u ka bërë thirrje protestueseve të lirojnë rrugën dhe të shpërndahen, duke iu dhënë një afat prej 5 minutave. Thirrja është përsëritur disa herë. Ndërsa, në anën tjetër, nga protestuesit, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Albin Kurti, me një megafon ka mbajtur një fjalim, përmes të cilit bënte thirrje kundër produkteve të Serbisë dhe kërkonte nga policia që të mos intervenojë, ngase protestuesit janë paqësorë dhe të paarmatosur.
17. Në ndërkohë, policia ka kërkuar, që prapa kordonit të policisë, të largohen gazetarët dhe personat e tjerë që gjendeshin përreth. Më pas, rreth 5 minuta më vonë, policia kërkoi që gazetarët dhe personat e tjerë, që monitoronin protestën, të vendoseshin anash kordonit të policisë.
18. Në orën 14:27, policia filloi të shtynte me mburoja protestuesit dhe të përdorë sprej, me qëllim të shpërndarjes së tyre, edhe pse shumica e protestuesve, në radhët e para, qëndronin ulur. Policia filloi të nxjerrë me forcë dhe të arrestojë disa protestues. Në këto momente, disa protestues që ishin anash rrugës, filluan të gjuanin kordonin e policisë me

mjete të forta, gurë, por edhe me mjete të tjera. Në këtë rast pjesëtarët e policisë u tërhoqën, diku rreth 20-30 metra prapa.

19. Mbajtësit e rendit të protestuesve (kujdestarët), gjatë gjithë kohës, kërkuan që të mos sulmohej policia, mirëpo situata tanimë ishte përshkallëzuar dhe policia kishte filluar të përdorte edhe gazin lotsjellës.
20. Dy kordonët e policisë, që ishin njëri pas tjetrit, në një distancë prej 20-30 metrash, të cilëve u erdhi në ndihmë edhe një autocisternë me ujë për shpërndarjen e protestuesve, u bashkuan dhe filluan të marshonin përpara në drejtim të protestuesve. Gjatë kësaj kohe nuk vërehej se protestuesit sulmonin policinë, me ndonjë përjashtim të rrallë. Protestuesit u shtynë rreth 50-100 metra dhe u ndanë në dy grupe, njeri në drejtim të qytetit të Podujevës, ndërsa tjetri në magjistrale, në drejtim të Prishtinës. Policia, gjatë kësaj kohe, përdori gazin lotsjellës kundër të dy grupeve të protestuesve, si dhe brenda në qytet.
21. Në orën 14:40, njëri ekip i vëzhguesve të IAP-së vizitoi Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF) në Podujevë, ku kishin filluar të vinin persona të lënduar. Njëri nga ta ishte edhe protestuesi me emrin B. B.⁸, që e kishte një plagë në kokë, për të cilën pohonte se “*e kishte marrë nga një mjet i fortë dhe nuk ishte i sigurt se kush e kishte goditur*”, ndërsa një protestues tjetër me emrin D. E., ishte lënduar nga gazi lotsjellës.
22. Në QMF të Podujevës, përfaqësuesit e IAP-së janë takuar dhe kanë biseduar me drejtorin, z. Zaim Thaçi, i cili deklaroi se kishin kapacitete të mjaftueshme dhe informoi se nga Prishtina kishin ardhur në ndihmë katër ekipe mjekësore, duke pohuar se çdo gjë ishte në rregull.
23. Në orën 15:25, Avokati i Popullit, me disa bashkëpunëtorë vizitoi pikën kufitare në Merdare dhe u takua me komandantin e pikës kufitare, z. Vladimir Qirkoviq, i cili pohon se nuk ka pasur asnjë incident në këtë pikë kufitare. Kamionët që hynin në Kosovë, përmes kësaj pike, përcilleshin nga policia e trafikut deri në terminalin doganor në Podujevë.
24. Në orën 15:50, Avokati i Popullit, me bashkëpunëtorët e tij, arritën në stacionin policor në Podujevë, ku fillimisht u takua me togerin z. Agim Vitia, i cili njoftoi se deri në këto çaste ishin arrestuar 24 protestues. Po ashtu, ai pohoi se në këtë stacion kishte kapacitete të mjaftueshme për të menaxhuar situatën me të arrestuarit, ndërsa ishin njoftuar edhe ekipet mjekësore mobile për të ofruar ndihmën mjekësore për të arrestuarit, si dhe për policët, meqë 5 deri 8 prej tyre ishin të lënduar.
25. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij vazhduan të vizitojnë të arrestuarit në sallat ku po mbaheshin të privuar nga liria, si dhe në dhomat ku intervistoheshin të arrestuarit.
26. Nga deklaratat e të arrestuarve, të cilët kishin qenë pjesëmarrës në protestë (N. Sh., G. K., H. D., B. M., Sh. M., S. Z., N. S., G. G., N. K., L. B., A. L., H. H., F. M., N. V., U. H., A. H., A. H., F. H., G. L., N. K., B. N., L. Rr., A. F., G. I. dhe K. M.) u pohua se intervenimi i policisë ishte tejet brutal dhe se maltretimet ndaj tyre nga ana e policisë, kishin vazhduar edhe gjatë e pas arrestimit, deri në stacion policor.
27. Shumica prej të arrestuarve kishin shenja dhe lëndime, si pasojë e përdorimit të forcës, në pjesë të ndryshme të trupit. Po ashtu, shumica prej tyre, pohonin se ishin fyer dhe poshtëruar nga ana e pjesëtarëve të Njësisë Speciale, “*duke u tërhequr zvarrë, duke u rënë me shqelma, me gjunjë, me grushte e bërryla, duke i shkelur në kokë, në qafë dhe në pjesë të tjera të trupit, si dhe duke u kërcënuar: do t’ju mbysim krejt*”.⁹ Fjalori i përdorur nga pjesëtarët e njësisë speciale ishte jashtëzakonisht vulgar, fyes dhe degradues. Ata fyenin në baza politike, personale dhe familjare me fjalët dhe shprehjet më banale dhe poshtëruese. Ndërkaq, të gjithë ishin pyetur se a janë aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje.

⁸ Emrat e plotë, deklaratat dhe fotografitë e bëra me këtë rast, gjenden në dokumentacionin e IAP.

⁹ Deklarata e N. Sh. dhe tjerët, të dhëna në lokalet e stacionit të policisë në Podujevë, më (14.1.2012).

28. J. Sh., të cilit i vëreheshin lëndime në kokë, pohoi se *“kam një dhëmbë të thyer dhe se nuk jam në gjendje të flas shumë për dhunën”* që kishte përjetuar, ai kërkoi që t’i ofrohet ndihma mjekësore, e cila pas disa minutave edhe i ofrohet.
29. N. B., pohoi se ishte goditur në *“pjesën e stomakut dhe në shpinë.”* Ai, po ashtu, kishte kërkuar nga pjesëtarët e policisë që t’ia lirojnë pak lidhësen e plastikës në duar, sepse kishte dhembje të mëdha, mirëpo një veprim i tillë nuk ishte ndërmarrë nga policia.
30. Ndërsa, (M. A., H. R., H. H., Sh. K., J. G., B. H., B. R.), pohuan se nuk kishin qenë pjesëmarrës në protestë por se kanë qenë kalimtar rasti në qytet. Madje B. H. pohoi se ishte arrestuar derisa po kthehej nga puna, i cili ishte nxjerrë nga vetura e tij
31. A. K. pohoi se ka qenë kalimtar i rastit. Ai është arrestuar nga një pjesëtar i Njesisë Speciale të policisë, i cili kishte përdorur forcë. Tek ai vëreheshin edhe lëndimet që kishte pësuar, kurse në fytyrën e këtij personi vëreheshin lëndimet nga gazi lotsjellës. Ai, më tutje, pohoi se *“ndihma mjekësore i ishte ofruar nga ekipet mobile të mjekëve në stacion policor.”*
32. Po ashtu policia, në një rast, kishte hyrë dhe kishte arrestuar, në oborrin e shtëpisë, njërin nga të ndaluarit, i cili pohonte se nuk ishte pjesëmarrës në protestë dhe se ishte duke qëndruar në oborrin e tij.¹⁰
33. Numri i të arrestuarve në orën 16:40 kishte arritur në 50 persona. Gjatë kësaj kohe, njëri nga bashkëpunëtorët e IAP-së, derisa ishte duke monitoruar intervistimin dhe marrjen në pyetje të një të arrestuari, në katin e parë, afër sallës ku po mbaheshin dhjetëra të arrestuar, në korridor, vëren dy pjesëtarë të Njesisë Speciale, të cilët sollën dy të arrestuar. Njëri nga policët, derisa e dërgonte të arrestuarin B. L., në sallën ku mbaheshin të arrestuarit tjerë, e godet atë me shqelma këmbëve, edhe pse i arrestuari ishte me duar të lidhura.
34. Përderisa përfaqësuesi i IAP-së vazhdonte të vizitojë të arrestuarit, në sallën ku po mbaheshin, pjesëtari i policisë, i cili u vërejt duke e goditur të arrestuarin, i drejtohet përfaqësuesit të IAP-së: *“çfarë do brenda në sallë?”* dhe pyet *“kush je ti?”* Përfaqësuesi i IAP-së, edhe pse kishte kartelën identifikuese që dukej, e informon policin, i cili nuk kishte asnjë shenjë identifikuese, se ishte nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe se ishte duke vizituar të ndaluarit në stacionin e policisë.
35. Pjesëtari i Njesisë Speciale të policisë, me një ton të egër dhe me urdhër të prerë, kërkon nga përfaqësuesi i IAP-së të dalë jashtë sallës. Përfaqësuesi i IAP-së e pyet pse duhet të del jashtë, duke e informuar policinë se është duke e kryer punën e tij, në pajtim me ligjin. Mirëpo përgjigjja e policit ishte se nuk i intereson fare dhe sërish, në prani edhe të zyrtarëve të tjerë policorë (emrat e të cilëve janë të njohur për IAP-në, si p.sh. z. Fatmir Topalli) dhe të të arrestuarve kërkon nga përfaqësuesi i IAP-së ta lëshojë sallën. Meqë polici i Njesisë Speciale, nuk kishte numër identifikues, ishte i pamundur identifikimi i tij.
36. Përfaqësuesi i IAP-së, pas këtij urdhri detyrohet të lëshojë sallën, kalon në korridor. Derisa përfaqësuesi i IAP-së ishte duke mbajtur shënime për ngjarjen, polici në fjalë, në këto momente del nga salla dhe i drejtohet përfaqësuesit të IAP-së me fjalët: *“Po shkruan tash, a? Marre duhet me ju ardh çka po bëni?”*. Duhet theksuar se në këto momente ishte i pranishëm një pjesëtar civil i policisë N. S.
37. B. L., i cili u godit nga pjesëtari i Njesisë Speciale të policisë, në prani të përfaqësuesve të IAP-së, pohoi se *“ishte keqtrajtuar fizikisht në furgonin e policisë, derisa kishte ardhur në stacion,”* dhe si pasojë e goditjeve i vëreheshin lëndimet në sy. Së bashku me B. L., në të njëjtin furgon kishin qenë edhe B. S. dhe A. H., të cilët po ashtu pohuan se *“ishin keqtrajtuar fizikisht gjatë rrugës deri në stacionin e policisë.”*

¹⁰ Deklarata e A.A. e dhënë në lokalet e stacionit të policisë në Podujevë, më (14.1.2012).

38. Në orën 17:35 numri i të arrestuarve arrin në 66 persona. Gjatë kësaj kohe, përfaqësuesit e IAP-së bisedojnë me të ndaluarin Sh. A., i cili sapo ishte sjellë në stacion policor. Ai pohoi se *“sjelljet e policisë, gjatë arrestimit të tij, kishin qenë korrekte dhe se nuk kishte ndonjë ankesë.”*
39. F. I., i cili ishte në detyrën e kujdestarit të protestës, deklaroi se gjatë arrestimit policia e kishte goditur në pjesë të ndryshme të trupit, duke e tërhequr zvarrë. Sipas tij, gjatë transportit me furgon për në stacion të policisë, sjelljet e policisë ishin degraduese dhe fyese *“një nga pjesëtarët e policisë shkeli me këmbë mbi trupin e tim, derisa isha i shtrirë me duar të lidhura në furgon. Policin nuk munda ta identifikoj, pasi që nuk kishte numër identifikues, por e mbaj mend se kishte sy të kaltër.”*
40. Në orën 18:10, përfaqësuesit e IAP-së takohen me deputeten e Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Albana Gashi, e cila ishte arrestuar. Ajo pohon se gjatë arrestimit dhe sjelljes në stacion policor, ishte fyer nga ana e pjesëtarëve të policisë. Ajo po ashtu kishte parë edhe disa raste të arrestimit të kalimtarëve të rastit.
41. Përfaqësuesit e IAP-së në orën 19:45, nëpërmjet një bisede telefonike me drejtorin e QMF-së në Podujevë, u informuan se rreth 30 persona kishin kërkuar ndihmë mjekësore, shumica prej të cilëve ishin trajtuar në këtë qendër, përveç tre personave, të cilët me kërkesën e tyre ishin transferuar në Prishtinë. Drejtori i QMF-së në Podujevë informoi se ekipet mobile kishin trajtuar edhe 20 persona të tjerë në terren dhe në stacionin policor në Podujevë.
42. Përfaqësuesit e IAP-së, në orën 20:40, zhvilluan një takim me kapitenin z. Nuhi Xhema, i cili informoi se deri në këtë kohë, ishin mbi 100 të arrestuar dhe se gjendja tani ishte normalizuar. Ishte bërë identifikimi i të arrestuarve dhe ishte njoftuar edhe prokurori publik. Ai pohoi se ende janë brenda afateve ligjore dhe së shpejti pritet të merret vendim për të arrestuarit.
43. Të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës që gjendeshin në stacionin policor të Podujevës, me të cilët janë takuar përfaqësuesit e IAP-së, qofshin ata civilë apo të uniformuar, janë sjellë në mënyrë korrekte dhe ishin të gatshëm të ofronin ndihmën e kërkuar, qoftë nga përfaqësuesit e IAP-së apo edhe të arrestuarit që silleshin apo gjendeshin në stacionin e policisë.
44. Nga sjelljet e vërejtura gjatë protestës, si dhe në stacionin e policisë në Podujevë, sikurse ndaj të arrestuarve, ashtu edhe ndaj përfaqësuesve të IAP-së, mund të konkludohet se ekziston një dallim midis pjesëtarëve të Njësisë Speciale të Policisë dhe pjesëtarëve të zakonshëm të policisë, qofshin ata civilë apo të uniformuar. Nëse ky dallim nuk ka të bëjë me vija të ndryshme komanduese, atëherë është vërejtur se kjo domosdoshmërisht ka të bëjë me mënyrën e trajnimit të tyre paraprak.
45. Pa marrë parasysh ngarkesat emocionale, lodhjen, stresin e grumbulluar, apo edhe mllëfin e grumbulluar për shkak të konfrontimit të drejtpërdrejtë fizik me protestuesit, me të cilët ballafaqohen pjesëtarët e Njësisë Speciale të Policisë, ashpërsia në sjellje, përdorimi i pakontrolluar i forcës, dhe sidomos shfrenimi verbal ndaj protestuesve dhe personave të tjerë me fyerje dhe poshtërime, është absolutisht i papranueshëm, i dënueshëm dhe i kundërligjshëm.
46. Po ashtu në IAP është paraqitur një rast nga qytetarët, i cili kishte të bënte me veprimet e një zyrtari të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) gjatë protestës së 14 janarit 2012 në Podujeve. Në bazë të fotografive vërehet se një nga zyrtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës ishte i përfshirë në arrestimin e një protestuesi.¹¹ Me gjithë shpjegimet se zyrtari në fjalë i është përgjigjur thirrjes së kolegëve të vet për ndihmë për arrestimin e një

¹¹ Rasti është pranuar më 18 .01. 2012 përmes postës elektronike në adresën zyrtare të IAP.

protestuesi, dhe premtimeve të udhëheqësve të IPK për “mbajtjen e neutralitetit”, ende pa u sqaruar nëse vetë akti i arrestimit ishte ligjor apo jo, vë në dyshim neutralitetin e IPK.¹²

Zhvillimi i situatës në Podujevë, më 22 janar 2012

47. IAP kishte dërguar dy ekipe me nga dy bashkëpunëtorë. Vëzhgimi ka filluar prej orës 9:30. Përgjatë gjithë rrugës Prishtinë - Podujevë vërehej prania e shtuar e policisë. Patrullat ishin vendosur në fshatrat Vranidoll, Lluzhan dhe Sibovc, ndërsa dy patrulla policie te udhëkryqi, te Hotel Besiana një patrullë, dhe në ndarjen e rrugës për Ballovc pesë patrulla, të cilat i ndaluan ekipet e IAP-së dhe treguan sjellje korrekte. Edhe në Shtedin, ku ishin dy patrulla, gjithashtu ndaluan ekipet e IAP-së, duke u sjellë në mënyrë korrekte, sikurse në Livadicë, ku ishin tri patrulla policie. Rrugës ishin vendosur edhe vetura të KFOR-it dhe të EULEX-it dhe njësi të policisë kufitare. Në kufi ishte vendosur Njësia Speciale, kryesisht me automjete.
48. Rreth orës 11:15, masa filloi të grumbullohej dhe policia kishte bërë përgatitjet për t'i ndaluar protestuesit ndërmjet dy urave, afër Hotelit Besiana. Vëzhguesit e IAP-së, të papenguar nga askush, kanë qëndruar mbi të dy urat midis të cilave ishin vendosur protestuesit
49. Në të djathtë të rrugës, pak më shmangët, pas urës së dytë, në drejtim të vendkalimit Merdare ishte vendosur Njësia Speciale.
50. Në orën 12:30, një pjesë e protestuesve filloi të lëvizte në drejtim të Merdares, por policia e vendosur aty nuk lejoi të shkohej më tutje. Protestuesit brohorisnin parulla të ndryshme. Organizatori vazhdimisht tërhoqte vërejtjen që të mbahet rend dhe të vendosen vetëm në njërin korse të rrugës, edhe pse masa ishte e shpërndarë gjithandej në të dy anët e rrugës dhe mbi ura. Organizatorët vazhdimisht tërhoqnin vërejtjen protestuesve për të mbajtur anën e majtë të rrugës dhe se ata kishin dalë të ndalonin Serbinë dhe mallrat serbe e nuk kanë asgjë kundër policisë.
51. Policia, mbi urën e dytë në drejtim të Merdares nga Prishtina, përpiquej të mbaj rendin dhe përveç gazetarëve, vëzhguesve dhe personave zyrtarë, nuk lejonte të qëndronin qytetarët. Mbi këtë urë qëndronte edhe ish-shëfi i misionit të OSBE në Kosovë, z. W. Woker.
52. Herë pas here nga turma gjuhej ndonjë top bore në drejtim të policisë, që dukej paksa provokuese. Me protestuesit ishin bashkuar edhe shumë qytetarë kureshtarë, të cilët qëndronin në breg, duke shikuar dhe duke bërtitur herë pas herë ndonjë parullë.
53. Në 13:10, përsëri thirrje nga organizatorët që të lirohej rruga për veturat e Kosovës dhe gazetarët, sepse ata janë aty “*për të ndaluar kamionat e Serbisë, për ta mbrojt Kosovën nga Serbia.*” dhe se “*ne do të jemi të qetë edhe nëse prapë ata do të përdorin dhunë.*”
54. Në orën 13:20, organizatori bënte thirrje për ata persona që qëndronin në breg që t'i bashkoheshin turmës.
55. Vëzhguesit e IAP-së biseduan me komandantin e Njesisë Speciale, pasi disa pjesëtarë të saj nuk mbanin numra identifikues. Arsyeja, sipas komandantit të Njesisë Speciale të Policisë ishte se policët kanë veshur “*jakne të nxehta*” mbi uniformat, për shkak të ftohtit. Ndërsa, nga përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Xhelal Sfeqla, janë njoftuar se do të qëndrojnë këtu deri sa të munden.
56. Në orën 14:57, një kamion me tabela të Maqedonisë, nën përcjelljen e policisë lëvizi nga drejtimi i Merdares në drejtim të Prishtinës dhe nuk u pengua nga protestuesit

¹² Komunikatë për media, 19.01.2012, e IPK: “*Jemi neutralë dhe luftojmë veprat kriminale të policëve*”, në: <http://www.kohaditore.com/?page=1.13.84691> (05.02.2012).

57. Pas orës 17:00, filloi të errësohej dhe nuk kishte pamje të qartë. Njësia Speciale, e cila filloi t'u afrohej protestuesve, ndezi një reflektor, të cilin e vendosi në urën, ku ishin të vendosur vëzhguesit, duke i larguar të gjithë prej urës. Protestuesit bënë thirrje të krijohet një distancë prej dy metrash nga kordoni i policisë.
58. Në orën 18:05, u afhua një kamion para protestuesve dhe policia shkarkoi barriera të metalta, të cilat u vendosën anash rrugës, duke lënë të lirë lëvizjen për automjete. Menjëherë pas kësaj policia kërkoi të lirohet rruga dhe të vendosen në anën e majtë, që u respektua nga masa.
59. Në orën 19:30, protestuesit ndezën një zjarr të madh, dhe me këtë rast disa protestues u detyruan t'i kalonin barrierat e vendosura për t'u larguar nga zjarri. Pas disa minutave erdhën zjarrfikësit, me qëllim të lokalizimit të zjarrit, ndërkohë zjarri u shua dhe nuk kishte nevojë për ndërhyrjen e zjarrfikësve.

Zhvillimi i situatës te Dheu i Bardhë, më 14 janar 2012

60. Në pikën kufitare te Dheu i Bardhë, situata gjatë ditës ishte e qetë, përveç se kishte forca të shtuara të policisë, sidomos në hyrje të rrugëve të fshatrave të banuara me serbë Kufcë, Shillovë, Kmetoc, Ranillug, Ropotovë dhe Korminjan.
61. Në vendin e quajtur "Crep", aty ku ndahet rruga për në Kamenicë nga rruga që shpie për te pika kufitare Dheu i Bardhë, policia i kishte ndaluar të gjithë autobusët me protestues dhe këta të fundit nga ky vend deri në afërsi të pikës kufitare kishin ecur në këmbë.
62. Përfaqësuesit e IAP-së u takuan me komandantin e stacionit policor në Gjilan, z. Ridvan Xhemaili, i cili informoi se ishte arritur një marrëveshje me protestuesit që të qëndrojnë në atë distancë të pikës kufitare, në ndarjen e rrugës për në Hogosht, gjë të cilën e konfirmuan edhe përfaqësuesit e protestuesve.
63. Në orën 13.50, protestuesit tentuan të lëvizin në drejtim të kufirit, por u penguan nga forcat e shumta policore. Gjendja vazhdoi të ishte e qetë, nuk vërehej ndonjë lëvizje e kamionëve, mirëpo kishte automjete (vetura), që lëviznin në të dyja anët e kufirit, pa u penguar prej askujt, përfshirë këtu edhe protestuesit, pasi njëra korse e rrugës ishte e lirë.
64. Deri në orën 17.00, tek pika kufitare Dheu i Bardhë protesta kaloi e qetë. Rreth orës 17.00, komandanti i stacionit të policisë, kërkoi nga protestuesit të lirojnë korsënë, e cila ishte e bllokuar gjatë tërë kohës së protestës, mirëpo kjo nuk u pranua nga protestuesit. Me këtë rast pasoi intervenimi i policisë për t'i larguar protestuesit nga një pjesë e rrugës. Protestuesit u ulën dhe ishin paqësorë. Policia fillimisht arrestoi disa nga udhëheqësit e protestës, pastaj vazhdoi edhe me arrestime të tjera, duke përdorur forcën ndaj tyre, me ç'rast nuk u kursyen as të moshuarit, invalidët, mediat e deputetët.
65. Përfaqësuesit e IAP-së, në orën 18.30 vizituan stacionin e policisë në Gjilan dhe biseduan me zyrtarët e policisë, ku u njoftuar për arrestimin e 34 personave. Më pas, përfaqësuesit e IAP-së vizituan disa nga të arrestuarit, të cilët pohuan se kanë vërejtje në policët, për shkak të keqtrajtimit gjatë arrestimit, ndërsa për kohën pas arrestimit nuk kanë ankesa, pasi në stacion policor ata ishin trajtuar mirë.
66. Protesta tek pika kufitare Dheu i Bardhë përfundoi në orën 20.45, kur protestuesit hynë në autobusët e tyre dhe u larguan nga vendi i protestës nën përcjelljen e policisë.
67. Përfaqësuesit e IAP-së, në orën 21.15, sërish e vizituan stacionin e policisë në Gjilan, ku u takuan me drejtoreshën e Policisë Rajonale, e cila informoi se prej 34 personave të arrestuar, 16 tashmë ishin liruar, ndërsa ndaj 18 të tjerëve ende zhvilloheshin procedurat e marrjes së deklaratave, të cilat ishin në përfundim e sipër dhe se pritet që para skadimit të afatit ligjor prej 6 orëve, të vendoset lidhur me mbajtjen ose lirimin e tyre. Sipas

drejtoreshës, asnjë nga protestuesit nuk ishte lënduar, ndërsa ishin lënduar 3 pjesëtarë të policisë.

68. Në bazë pamjeve të drejtpërdrejta dhe dëshmime të ofruara, protestuesit gjatë tërë kohës kanë qenë të qetë, nuk kanë përdorur forcë në asnjë moment, madje as kur ka intervenuar policia.

Zhvillimi i situatës te Dheu i Bardhë, më 22 janar 2012

69. Monitorimi i protestës tek pika kufitare Dheu i Bardhë është bërë nga dy ekipe të IAP-së dhe ka filluar në orën 10:00 deri në orën 21:00, të datës 22 janar 2012.
70. Përfaqësuesit e IAP-së, në orën 11:00, vizituan pikën kufitare tek Dheu i Bardhë. Përgjatë rrugës Gjilan - Dheu i Bardhë vërehej prani e shtuar të policisë, ndërsa në pikën kufitare vërehej një numër më i madh i pjesëtarëve të policisë, e në mesin e tyre kishte edhe disa pjesëtar të njësisë speciale të pajisur me helmata dhe mjete tjera mbrojtëse.
71. Policia e Kosovës kishte ndërprerë qarkullimin e autobusëve dhe veturave me protestues në udhëkryqin, ku ndahet rruga për Kamenicë nga rruga që shpie për te pika kufitare Dheu i Bardhë. Policia lejonte të kalonin vetëm veturat që kishin për destinacion kalimin e kufirit, si dhe veturat e vëzhguesve dhe të mediave, ndërsa protestuesit nga ky udhëkryq deri tek pika kufitare vazhdonin të ecnin në këmbë.
72. Në orën 12:30, protestuesit filluan të grumbulloheshin tek pompa e benzinës "Albina Petrol", diku rreth 300 metra larg pikës kufitare, vend ky ku policia kishte ndaluar edhe javën e kaluar protestuesit. Vlen të theksohet se në kordonin e policisë nuk vërehej ndonjë pjesëtar i njësisë speciale, pasi ata dukeshin 100 metra larg kordonit dhe ishin vendosur shumica brenda një objekti skaj rruge.
73. Në orën 13:00, përfaqësuesit e IAP-së biseduan me komandantin e policisë z. Ridvan Xhemaili, i cili pohoi se çdo gjë deri me tani ishte në rregull dhe se kishin informuar protestuesit që mos të bllokojnë dy korsetë e rrugës, gjë të cilën e kishin pranuar edhe protestuesit. Ne e pyetëm komandantin, lidhur me numrat identifikues, pasi shumica e policëve nuk i kishin numrat në uniformat e tyre. Pohimet e komandantit ishin se *"ky veprim nuk ka ndonjë qëllim të caktuar, por për shkak se shumica e policëve i kanë ndërruar uniformat dhe disa prej tyre për arsye të temperaturave të ulëta kanë veshur setra të dimrit shtesë dhe numrat u kanë mbetur brenda."*
74. Në orën 13:30, protestuesit filluan të brohorisin dhe disa prej tyre të bllokonin korsënë tjetër të rrugës, duke i shtyrë përpara kujdestarët e protestës, mirëpo një nga udhëheqësit e protestës iu drejtohet me fjalët: *"Ju lutem të gjithë të jenë të qetë, ju lutemi protesta është paqësore, askush të mos veprojë në kundërshtim me qëllimin e protestës."*
75. Në orën 13:45, përfaqësuesit e IAP-së biseduan me organizatorët e protestës. Me këtë rast, njëri nga udhëheqësve të protestës kishte një vërejtje sa i përket pjesëtarëve të policisë, duke pohuar se *"policia nuk është duke i bartë numrat identifikues dhe ky veprim i policisë është në kundërshtim me ligjin."*
76. Në orën 18:00, përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje i informuan vëzhguesit e IAP-së se në vendin e quajtur "Crep", në udhëkryqin ku ndahet rruga për në Kamenicë, policia i kishte ndaluar aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe atyre u ishin konfiskuar këto materiale: dhjetë reflektorë, një tendë, dy fuqi të zbrazëta. Sipas tyre këto materiale ishin të destinuara t'i shërbenin protestuesve që ata ta kalonin natën në pikën kufitare te Dheu i Bardhë.
77. Në orën 21:20, përfaqësuesi i IAP-së vizitoi stacionin e policisë në Kamenicë. Nga zyrtarët e stacionit policor u mësua se katër aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje janë ndaluar në udhëkryqin e quajtur "Crep" dhe atyre u është konfiskuar një sasi e druve për

ngrohje, e cila ishte paraparë t'u dërgohej protestuesve. Sipas zyrtarit të policisë, këta persona, pasi janë marrë në pyetje, janë dërguar në Drejtorinë Rajonale të Policisë në Gjilan.

78. Në orën 21:35, në afërsi të njërës nga pompat e derivateve tek Dheu i Bardhë, derisa një pjesë e protestuesve ishte duke u larguar nga protesta dhe dëshironte të hynte në autobus, ndodhi një përleshje në mes të protestuesve, të cilët përdorën edhe shkopinj. Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje ndërhyjnë për ta qetësuar situatën dhe nuk lejuan vazhdimin e përleshjes.
79. Në orën 22:00, përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje e shpallën të mbyllur protestën e 22 janarit 2012 dhe protestuesit të cilët kishin mbetur u shpërndanë.
80. Protestat e datës 22 janar 2012, për dallim nga ato të 14 janarit 2012, nuk janë përcjellë me akte të përdorimit të forcës nga ana e policisë dhe nuk është shënuar ndonjë incident në mes të protestuesve dhe policisë.
81. Më 22 janar, protestat në të dy pikat kufitare në Merdare dhe te Dheu i Bardhë janë zhvilluar të qeta. Pjesëtarët e policisë kanë qenë të angazhuar maksimalisht në mbajtjen e rendit dhe sjelljet e tyre gjatë gjithë kohës kanë qenë të qeta. Ata kanë mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me protestuesit dhe kanë kërkuar nga ana e tyre që mos të bllokojnë rrugën.
82. Në mbajtjen e rendit, gjatë protestës nuk ka pasur të angazhuar pjesëtarë të Njësisë Speciale dhe gjatë gjithë kohës ata kanë qëndruar larg nga protestuesit.
83. Një çështje që është vërejtur nga përfaqësuesit e IAP-së dhe që është ngritur edhe nga protestuesit është fakti se shumica e pjesëtarëve të policisë nuk mbanin numrat identifikues. Protestuesit, në veçanti organizatorët dhe kujdestarët kanë qenë të angazhuar dhe gjatë gjithë kohës së protestës kanë kërkuar që të sigurohet lëvizja e lirë në njërën korse të rrugës, si dhe të përmbahen nga veprimet provokuese.

Analiza ligjore e ngjarjeve

84. Nga e tërë kjo që u tha më lartë, Avokati i Popullit konsideron se intervenimi i policisë, përfshirë përzgjedhjen e mjeteve dhe të metodave, si dhe përdorimi i forcës, gjatë protestave më 14 janar 2012 në Podujevë dhe tek Dheu i Bardhë, ka qenë i panevojshëm, i pajustificueshëm dhe joproporcional.
85. E drejta e tubimit është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila është përcaktuar qartë në instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat e mbrojnë të drejtën e lirisë për tubim.¹³
86. Në përputhje të plotë me instrumentet e lartpërmendura ndërkombëtare, derisa ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës, veç tjerash, bazohet edhe në “[...] respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, [...]”¹⁴, edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është e garantuar “Liria e tubimit paqësor”, dhe “Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to”.¹⁵ Kjo e drejtë në Republikën e Kosovës, si kategori kushtetuese, me gjithë kufizimet e domosdoshme ligjore, asnjëherë dhe në asnjë mënyrë, në kushtet e gjendjes së zakonshme, nuk guxon të privohet nga substanca e saj. Kufizimet ligjore të kësaj të drejte, nëse kjo “është e domosdoshme për të siguruar rendin dhe sigurinë publike,

¹³ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 20, par. 1; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike, neni 21, si dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 11.

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3.2.

¹⁵ Po aty, neni 43.

shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve”¹⁶, përcaktohen me ligj.¹⁷

87. Çfarëdo lloj demonstrimi në vend publik, qofshin ato protesta, manifestime apo forma të ndryshme të shprehjes së pakënaqësisë, mund të shkaktojë nivel të caktuar të shqetësimit në jetën e rëndomtë, përfshirë ndërprerje në trafik. Dhe kur demonstruesit nuk përfshihen në akte të dhunës, “për autoritetet publike është e rëndësishme të tregojnë shkallë të lartë të tolerancës kundrejt tubimeve paqësore nëse liria e tubimit, e garantuar nga neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, nuk është për t’u privuar nga substanca e saj.”¹⁸
88. Përgjithësisht, në fillim arrestimet janë bërë në mënyrë përzgjedhëse, me fokus të veçantë tek organizatorët, sidomos deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës të pranishëm në protestë. Po ashtu, bazuar në deklaratat e shumicës nga të arrestuarit në stacionin e policisë në Podujevë, gati të gjithë pa përjashtim janë pyetur nëse janë aktivistë të Vetëvendosjes (shih paragrafin 27, më lart). Ky është veprim i kundërligjshëm që cenon ligjet vendore mbi paanshmërinë dhe neutralitetin, të përcaktuara me Kodin e Etikës të Policisë së Kosovës¹⁹, si dhe parimet bazë të Kodit Evropian të Etikës Policore.²⁰
89. Sidomos është për t’u theksuar fakti se janë arrestuar persona të cilët nuk ishin të dhunshëm kundër pjesëtarëve të policisë dhe nuk kishte rrezik të kryerjes së veprave kriminale.²¹ Madje edhe disa orë pas intervenimit fillestar të policisë, janë arrestuar persona të cilët nuk ishin fare të involvuar në protestë (shih paragrafët 30, 31 dhe 32 më lartë).²²
90. Avokati i Popullit konsideron se, në kryerjen e rolit të saj, policia është e obliguar dhe duhet të ketë synim parësor mbrojtjen të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Për këtë e obligon ligji vendor dhe obligimet e marra ndërkombëtare.²³ Këtu sidomos theksohet mbrojtja e të drejtave të njeriut sipas parimeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut, e cila jo vetëm obligon për mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe lirive, por

¹⁶ *Po aty*, neni 43.

¹⁷ *Ligji për tubimet publike*, Nr. 03/L-118, neni 5, par. 3: “Organet kompetente për mbajtjen e rendit dhe të qetësisë e sigurisë mund të ndër marrin masa të përdorimit të dhunës vetëm atëherë kur tubimi publik përkatësisht protesta rrezikon të prish ose shkatërroj të mirat e përgjithshme.”

¹⁸ *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut*, shih rastin *Balçik and Others v. Turkey* (Application no. 25/02) paragrafi 52 dhe *Ashughyan v. Armenia* (Application no. 33268/03), paragrafi 90.

¹⁹ *Ligji për policinë*, Nr. 03/L-035, neni 2, Parimet udhëzuese: “c) paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave;”

²⁰ *The European Code of Police Ethics*, Recommendation Rec (2001)10 of the Committee of Ministers to member states on the European Code of Police Ethics (Adopted by the Committee of Ministers on 19 September 2001 at the 765th meeting of the Ministers’Deputies) [Në tekstin e mëtejshëm si: **The European Code of Police Ethics**]. V. Udhëzimet për veprimin/intervenimin policor, A. Udhëzimet për veprimin/intervenimin policor, parimet e përgjithshme: “40. Policia do të duhet të kryente detyrat e saj në mënyrë të drejtë, dhe posaçërisht e udhëhequr nga parimet e paanshmërisë dhe mos diskriminimit.”

në: <http://polis.osce.org/library/f/2687/500/CoE-FRA-RPT-2687-EN-European%20Code%20of%20Police%20Ethics.pdf> (12.02.2012).

²¹ *Venice Commission*, Study no. 581/2010. Strasbourg- Warsaw, 9 July 2010, par. 108.: “Ndalimi i pjesëmarrësve gjatë një tubimi (në baza të kryerjes së veprave administrative, penale etj.) duhet të bëhet me shumë kujdes, duke pasur parasysh të drejtën e lirisë dhe të sigurisë të personit si dhe faktin se, ndërhyrja në të lirinë e tubimit është jashtëzakonisht e ndjeshme në aspektin kohor. Ndalimi duhet të bëhet vetëm në situatat e tendosura kur mosndalimi i personit do të rezultonte në kryerjen e veprave serioze kriminale.”

²² *Po aty*, par. 158.: “Zyrtarët për zbatim të ligjit duhet të bëjnë dallimin ndërmjet pjesëmarrësve dhe jo pjesëmarrësve.”

²³ *Ligji për policinë*, Nr. 03/L-035, neni 2, pika b. Shih, po ashtu, *The European Code of Police Ethics*, I. Objektivat e policisë– “të mbrojnë dhe respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të individëve, të parapara, sidomos në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

njëkohësisht vendos edhe kufijtë e veprimit policor, duke udhëzuar se deri ku mund të shkojë policia për të arritur “objektivat e ligjshëm policorë”.²⁴

91. Avokati i Popullit, gjatë monitorimit të protestës të datës 14 janar 2012, ka vërejtur se, përveç në vendin e protestës, dhuna e pjesëtarëve të Njësisë Speciale është përdorur edhe gjatë transportimit të të arrestuarve dhe është përcjellë me veprime degraduese e poshtëruese. Po ashtu, gjatë ndërhyrjes së policisë forcë është përdorur edhe ndaj një përfaqësuesi të mediave, i cili ishte në krye të detyrës.
92. Këto veprime të pjesëtarëve të Njësisë Speciale të policisë janë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,²⁵ dhe Ligjin për policinë.²⁶
93. Ashtu sikurse neni 5 i Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut, neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, si dhe neni 7 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 27 garanton se në asnjë rrethanë, “Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.”
94. Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike, shprehimisht kërkon që: “Çdo person që privohet nga liria, duhet të trajtohet me humanizëm dhe respekt për dinjitetin që i përket çdo njeriu”.²⁷
95. Ligji për Policinë, që përcakton parimet e veprimit të Policisë së Kosovës, shprehimisht kërkon “Respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”²⁸, ndërsa në një nga parimet udhëzuese të policisë, sipas këtij ligji thuhet se: “Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës”²⁹. Kodi i Etikës i Policisë së Kosovës ligjërisht duhet “të jetë në përputhje të plotë me parimet e lartpërmendura dhe me Kodin Evropian të Etikës Policore.”³⁰
96. Po ky ligj, rregullon parimin e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit në veprimet e Policisë së Kosovës, përmes të cilit vë kufizime “në ushtrimin e autorizimeve policore”. Sidomos kur është në pyetje kufizimi i lirisë së personave, ky ligj kërkon shprehimisht që, “zyrtari policor duhet ta ketë parasysh maturinë, shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e kryerjes së veprës penale në atë situatë, për ta përcaktuar shkallën e kufizimit të lirisë së personit.”³¹
97. Ky ligj, jo vetëm rregullon parimet e përshtatshmërisë dhe të proporcionalitetit, por shprehimisht kërkon edhe vetëpërmbytjen dhe kërkon shprehimisht nga zyrtari policor që të mos “shkaktojë, nxisë, mbështesë ose tolerojë asnjë akt të torturës, degradimit ose trajtimit çnjerëzor në çfarëdo rrethanash, ndërsa asnjë rrethanë e jashtëzakonshme apo urdhër i lëshuar nuk do ta arsyetojë veprimin e tillë.”³²
98. Lidhur me parimin e vetëpërmbytjes, sidomos në rastet e domosdoshmërisë së përdorimit të forcës, kërkesa e këtij ligji për zyrtarin policor është jo vetëm që të “vepron me maturinë e tij/saj për ta përcaktuar llojin e forcës më të përshtatshme”, duke marrë parasysh edhe “rrethanat specifike, natyrën e veprës penale, shkallën e rrezikut ndaj

²⁴ Ligji për policinë, Nr. 03/L-035, neni 3: Përkufizimet – “Objektivi i ligjshëm i Policisë” – nënkupton synimin të cilin e ndjek Policia gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, që është në pajtim me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe me ligjin në fuqi.”

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3: “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.”

²⁶ Ligji për policinë, Nr. 03/L-035, neni 13, par. 3: “Zyrtari policor nuk do të shkaktojë, nxisë, mbështesë ose tolerojë asnjë akt të torturës, degradimit ose trajtimit çnjerëzor në çfarëdo rrethanash, ndërsa asnjë rrethanë e jashtëzakonshme apo urdhër i lëshuar nuk do ta arsyetojë veprimin e tillë.”

²⁷ Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile e Politike, neni 10.1

²⁸ Ligji për policinë, Nr. 03/L-035, neni 2.1, pika b.

²⁹ Po aty, neni 2.2.

³⁰ Po aty, neni 2.3.

³¹ Po aty, neni 12.2.

³² Po aty, neni 13.3.

personave të tjerë që janë të pranishëm dhe gjendjen fizike, mentale dhe emocionale të personit ndaj të cilit përdoret forca.”³³

99. Edhe po qe se vjen deri te përdorimi i forcës - dhunës fizike - kërkesa ligjore ndaj zyrtarit të policisë është që të bëjë përpjekje që ta “*minimizojë ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e personit dhe të minimizojë çfarëdo pasoje të dëmshme.*”³⁴
100. Avokati i Popullit konsideron se parimi i përpjesëtueshmërisë kërkon që ndërmjet forcës së përdorur dhe qëllimit legjitim për të cilin është përdorur ajo, duhet të ekzistojë një baraspeshë. Ky parim “*kërkon që të ketë një vlerësim të hollësishëm dhe objektiv të rrethanave të cilat afektojnë mbajtjen e një tubimi.*”³⁵
101. Avokati i popullit konsideron se forca e cila përdoret duhet të jetë proporcionale në realizimin e qëllimit të aksionit policor. Ndërsa, parimi i përmbajtjes paraqet përdorim të forcës në masë sa është e mundur më të vogël dhe nëse ajo domosdoshmërisht duhet të përdoret, të evitohet shkaktimi eventual i pasojave për shëndetin dhe jetën e njerëzve.³⁶ Dyshimi i thjeshtë ose supozimi nuk mund të konsiderohen arsye të mjaftueshme. Kjo ndodh sidomos në rastin kur shqetësimet e tubimit kanë të bëjnë me interesin publik ose kur përfshihet fjalimi politik.³⁷
102. Avokati i Popullit ka vërejtur se organizatorët e protestës në vazhdimësi kanë ftuar për qetësi dhe përmes kujdestarëve kanë bërë përpjekje që protesta të jetë paqësore, mirëpo përkundër përpjekjeve të tyre situata në një moment ka eskaluar. Një grup i caktuar personash nga vija anësore, ka hedhur gurë, kubëza çimentoje dhe sende tjera të forta. Megjithatë, “*organizatori nuk do të duhej të konsiderohej përgjegjës për veprimet e pjesëmarrësve individual*”, nëse ata kanë bërë përpjekje që protesta të jetë paqësore dhe se, “*përgjegjësia individuale vjen në shprehje për cilindo pjesëmarrës nëse ata bëjnë shkelje (kryejnë vepër penale).*”³⁸
103. Për më shumë, “*nëse një tubim degjeneron në çrregullim të rendit publik është përgjegjësi e shtetit - jo e organizatorit të ngjarjes që të kufizojë dëmin e shkaktuar.*”³⁹
104. Po ashtu, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vërejtur se “*një individ nuk pushon së gëzuarit të drejtën e lirisë së tubimit si rezultat i dhunës sporadike apo veprimeve tjera të ndëshkueshme, të kryera nga të tjerët gjatë zhvillimit të demonstratës, nëse individi në pyetje mbetet paqësor në synimet apo sjelljen e tij/saj.*”⁴⁰
105. Avokati i Popullit, më 14 janar 2012 ka vizituar shumicën e të arrestuarve, në stacionet policore në Podujevë. Nga deklaratat e tyre rezulton se janë bërë edhe arrestime arbitrare, në lokale të ndryshme afariste, si dhe në oborret e shtëpive, duke arrestuar edhe persona në vendet e tyre të punës, si dhe kalimtarë të rastit, që nuk ishin pjesë e protestës (shih paragrafët 30, 31 dhe 32 më lartë).⁴¹
106. Po ashtu, Avokati i Popullit ka vërejtur se arrestimet ishin përcjellë me përdorim të pakontrolluar të forcës dhe me fyerje e poshtërime, në baza personale edhe në baza

³³ Po aty, neni 25.3.

³⁴ Po aty, neni 25.4.

³⁵ Venice Commission, Study no. 581/2010. (Strasbourg- Warsaw, 9 July 2010), par. 41.

³⁶ Po aty, par. 176: “Parimet në vijim duhet të respektohen në të gjitha rastet kur përdoret dhuna në menaxhimin e tubimeve publike: - aty ku përdoret spreji apo mjetet tjera kimike ngacmuese, duhet të rregullohen procedurat e dekontaminimit; - përdorimi i projektilëve të butë energjikë (AEPs), i shkopinjeve të gomës, projektilëve të gomës/plasticës, i ujëhedhësve dhe metodave të tjera të dhunshme për kontrollimin e turmave, duhet të rregullohet në mënyrë strikte; - në kurrfarë rrethanash nuk guxon të përdoret forca kundër demonstruesve paqësorë të cilët nuk mund të largohen nga vendi i ngjarjes.”

³⁷ Po aty, par. 42.

³⁸ Po aty, par. 197.

³⁹ Po aty, par. 198.

⁴⁰ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, shih rastin *Ezelin v. France* (Application no. 11800/85) dhe rastin *Ziliberberg v. Moldova* (Application no. 61821/00).

⁴¹ Venice Commission, Study no. 581/2010. Strasbourg- Warsaw, 9 July 2010), par. 158: “Zyrtarët për zbatim të ligjit duhet të bëjnë dallimin ndërmjet pjesëmarrësve dhe jo pjesëmarrësve.”

gjinore, kryesisht nga pjesëtarët e Njësisë speciale të policisë. Ky përdorim i papërshtatshëm, i tepruar dhe joligjor i forcës është përcjellur me “shkelje të lirive themelore dhe të drejtave të garantuara, mund të minojë marrëdhëniet polici-bashkësi dhe në vetvete mund të shkaktojë tensione dhe trazira.”⁴²

107. Avokati i Popullit gjatë qëndrimit në stacionin policor në Podujevë më 14 janar 2012, ka vërejtur një angazhim të jashtëzakonshëm të pjesëtarëve të policisë dhe sjelljet e tyre korrekte, si ndaj përfaqësuesve të IAP-së po ashtu edhe ndaj të arrestuarve. Përfaqësuesit e IAP-së kanë vërejtur se në çdo rast, kur nga të arrestuarit është kërkuar ndihma mjekësore, janë ftuar ekipet mobile të mjekëve.
108. Mirëpo, kjo që u tha më lart nuk vlen edhe për njësitë speciale të policisë të Kosovës, të cilët më 14 janar 2012, në një rast përdorën forcë ndaj një të arrestuari, edhe brenda stacionit policor në Podujevë, në praninë e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit, të cilët në një moment u kërcënuan dhe u penguan në kryerjen e punëve të tyre nga ana e pjesëtarëve të Njësisë Speciale.
109. Përfaqësuesi i IAP-së nuk ka mundur të identifikojë zyrtarin policor, pasi në përgjithësi pjesëtarët e policisë, të cilët ishin caktuar për menaxhimin e protestave, nuk i posedonin numrat e tyre identifikues. Po ashtu, edhe shumica e të arrestuarve pohuan se ka qenë mjaft vështirë të bëhet identifikimi i zyrtarëve të policisë, edhe pse kërkesa ligjore⁴³ është që “Personeli i agjencisë për zbatimin e ligjit do të duhej të jenë të identifikueshëm në mënyrë të qartë dhe individuale.”⁴⁴
110. Mospërgjigja në kërkesat, pengimi dhe aq më shumë kërcënimin i përfaqësuesve të Avokatit të Popullit gjatë kryerjes së veprimeve ligjore, përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit të Republikës së Kosovës. Në stacionin e policisë në Podujevë, jo vetëm se është penguar në kryerjen e punës, por përfaqësuesi i Avokatit të Popullit është kërcënuar, në praninë e dëshmitarëve nga një pjesëtar i Njësisë Speciale të policisë.⁴⁵
111. Jashtëzakonisht shqetësues është fakti që, më 14 janar 2012, me gjithë marrëveshjen gojore në lidhje me hollësitë teknike të zhvillimit të ngjarjeve,⁴⁶ është përdorur forcë nga policia e Kosovës, duke përdorur shumë mjete të forcës policore të paraparë për përdorim nga policia⁴⁷ kundër grupeve të protestuesve.
112. Është për t’u përhëndetur fakti se, edhe pse nuk pati ndonjë takim apo marrëveshje për planifikim paraprak të zhvillimit të protestës të datës 22 janar 2012, madje megjithë tensionimin deklarativ midis organizatorëve të protestës – Lëvizjes Vetëvendosje – dhe qeverisë së Kosovës, nuk kishte asnjë veprim të dhunshëm të policisë së Kosovës gjatë

⁴² Po aty, par. 171.

⁴³ Ligji për Policinë, nr. 03/L-035, neni 14: “Para se t’i ushtrojë autorizimet policore, zyrtari policor do t’i njoftojë personat lidhur me statusin e tij/saj si zyrtar policor dhe, nëse nuk është në uniformë, do të prezantojë veten duke treguar kartelën e identifikimit ose shenjën e policisë.”

⁴⁴ Venice Commission, Study no. 581/2010. Strasbourg- Warsaw, 9 July 2010), Par. 153.

⁴⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, par. 3: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”

Ligji për Avokatin e Popullit, Nr. 03/L-195, neni 16, par. 7: “Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit në çdo kohë dhe pa paralajmërim mund të hyjnë dhe të inspektojnë çdo vend ku personat janë privuar nga liria si dhe në institucionet tjera me liri të lëvizjes së kufizuar dhe mund të jenë të pranishëm në mbledhje ose seanca dëgjimore ku përfshihen personat e tillë. Zyrtarët e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të mbajnë edhe takime me personat e tillë pa praninë e zyrtarëve të institucionit përkatës. Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Institucionin e Avokatit të Popullit nuk pengohet apo kontrollohet.”

⁴⁶ Avokati i Popullit nuk disponon me ndonjë dokument të shkruar për marrëveshjen midis organizatorëve të protestës dhe policisë së Kosovës më 12 . 01. 2012 për planifikimin paraprak të zhvillimit të protestës.

⁴⁷ Ligji për policinë, Nr. 03/L-035, neni 25.5: “Përdorimi i forcës, si term që përdoret në këtë ligj, përfshin por nuk kufizohet vetëm në përdorimin e: forcës fizike, shufrës zyrtare, sprejtit, mjeteve pranguese, mjeteve për ndalimin e automjeteve, qenit të policisë, mjeteve kimike për paaftësim të përkohshëm, kalit të policisë, armëve të zjarrit, topave të ujit, automjeteve dhe llojeve të veçanta të armëve dhe mjeteve shpërthyesë.”

protestës së zhvilluar më 22 janar 2012. Ditën e protestës madje nuk vëreheshin as shumë nga mjetet për përdorimin e forcës policore të përdorura më 14 janar, si ujëhedhësit kundër turmave. Kurse njësitë Speciale të policisë qëndronin në distancë nga turmat e njerëzve në të dy vendet e protestës, në Podujevë dhe Dheu i Bardhë.

113. Mospërmbajtja e policisë së Kosovës nga përdorimi i forcës në rastin e parë, më 14 janar, ashtu edhe vetëpërmbajtja në rastin e dytë, më 22 janar, nuk mund të shpjegohen vetëm me organizimin më të mirë më 22 janar. Shpjegimin për këtë ndryshim në sjelljen e policisë së Kosovës, sidomos sa i përket përdorimit të forcës ndaj protestuesve, duhet ta bëjnë në mënyrë ligjore organet kompetente hetuese. Në çdo rast të një hetimi të pavarur në lidhje me ngjarjet në protestat e 14 dhe 22 janarit 2012, duhet medoemos të kihet parasysh dhe të analizohen udhëzimet e dhëna në planet operative të Policisë së Kosovës.
114. Shqetësimi i veçantë i Avokatit të Popullit është se në Kosovë mungon një kulturë komunikimi për shmangie të dhunës. Edhe në rastet kur ka komunikim dhe ndonjë marrëveshje, ajo nuk respektohet. Mosrespektimi i marrëveshjeve nuk guxon të shpërblehet në një shoqëri të civilizuar.
115. Duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lart, bazuar në nenin 16, pika 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe nenin 135.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit,

REKOMANDON:

1. ***Të bëhet hetim gjyqësor i sjelljes së pjesëtarëve të policisë, të cilët kanë përdorur forcë ndaj protestuesve dhe qytetarëve të rastit, në protestën e datës 14 janar 2012 në Podujevë dhe në pikën kufitare Dheu i Bardhë***
2. ***Të identifikohen dhe të nxirren para drejtësisë të gjithë ata individë nga forcat e policisë, që kanë përdorur forcë dhe/ose urdhëruar përdorimin e forcës policore ndaj protestuesve më 14 janar 2012.***⁴⁸
3. ***Të identifikohen dhe të nxirren para drejtësisë të gjithë personat që kanë përdorur forcë gjatë protestës kundër Policisë së Kosovës.***
4. ***Të rishqyrtohet roli dhe misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës, të hetohen nga një institucion i pavarur dhe të ballafaqohen me përgjegjësinë ligjore, zyrtarët e këtij inspektorati që kanë shkelur kodin e etikës dhe rregulloren e veprimit të Inspektoratit Policor të Kosovës, më 14 janar 2012.***
5. ***Të ndërmerren masat disiplinore dhe ligjore ndaj pjesëtarit të Njesisë Speciale të policisë, i cili ka penguar punën e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ka kërcënuar përfaqësuesin e Institucionit të Avokatit të Popullit.***
6. ***Që për Njësine Speciale të policisë së Kosovës të organizohen trajnime të veçanta, në lidhje me menaxhimin e situatave gjatë ballafaqimit me turmat e mëdha të njerëzve në organizimet e ndryshme publike, të organizuara sipas udhëzimeve të Komisionit të Venedikut për protestat, me theks të veçantë për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.***⁴⁹

⁴⁸ *The European Code of Police Ethics*, IV. Strukturat organizative të policisë, Par. 16: “Personeli policor, në të gjitha nivelet, do të jetë personalisht përgjegjës dhe llogaridhënës për veprimet apo mosveprimet e tyre lidhur me urdhrat të cilat ua japin ndër vartësve të tyre.”, dhe Par. 17: “Organizimi policor do të duhej të jetë i tillë që siguron zinxhir të qartë komandues brenda policisë. Gjithmonë do të duhej e mundshme të përcaktohet se cili mbikëqyrës është përfundimisht përgjegjës për veprimet apo mos veprimet e personelit policor.”

⁴⁹ *Venice Commission*, Study no. 581/2010. Strasbourg- Warsaw, 9 July 2010), par. 147: “Trajnimi gjithashtu do të duhej të përfshinte çështjet relevante të të drejtave të njeriut dhe do të duhej të mbulonte kontrollin dhe planifikimin e operacioneve policore duke theksuar domosdoshmërinë e minimizimit të mundësisë së përdorimit të forcës në masën më të madhe të mundshme. Në këtë mënyrë, trajnimi mund të ndihmojë garantimin që

7. *Nga Ministria e Punëve të Brendshme kërkohet që të gjithë pjesëtarët e policisë së Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh formën, mënyrën dhe situatën e angazhimit dhe njësitë në të cilat operojnë, të pajisen me numër identifikues.*
8. *Policia e Kosovës, si institucion kushtetues për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike, e shëndetit publik, e sigurisë nacionale, e të drejtave dhe lirive të njeriut, duhet medoemos të kërkojë kontaktin me organizatorët e tubimeve publike për planifikim paraprak të tyre, kur kjo është e nevojshme, për shkak të vendit, kohës dhe numrit të pjesëmarrësve dhe nëse ato nuk janë të ndaluara shprehimisht, me vendim të veçantë.⁵⁰*

Në bazë të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 26 të Ligjit për Avokatin e Popullit, të na informoni për veprimet e ndërmarra, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura.

Me lutjen që, brenda afatit prej 30 ditësh, të na njoftoni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi, paraprakisht Ju falënderojmë për bashkëpunim.

Me nderime,

Sami Kurteshi
Avokat i Popullit

Kopje:

- Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.
- Komisioni Parlamentar për Gjyqësi dhe legjislacion.
- Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së.
- Inspektoratin Policor të Kosovës.
- Zyrës për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit.
- Zyrës për të Drejtat e Njeriut në MPB.

kultura dhe karakteri i agjencive të zbatimit të ligjit në mënyrë adekuate të portretizojnë veprimet policore me qasje të përqendruar në të drejtat e njeriut.”

⁵⁰ *Po aty*, Par. 149: “Institucionet e vendosjes së rendit dhe ligjit duhet të jenë proaktive në angazhimin me organizatorët e tubimeve: zyrtarët duhet të përpiqen të dërgojnë sinjale të qarta për informimin e pritjeve të turmës dhe të zvogëlojnë mundësinë e eskalimit të konfliktit.”